

# atrc

Qendra e Trajnimeve &  
Burimeve për Avokim



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA

Perkrah  
OJQ-te



Vëllimi V • Numri 4 • Prill 2007

## PËRMBAJTJA

### Faqe 2

Swiss Contact krijon mundësi  
për zhvillim ekonomik

Shoqëria civile e quan përrallë  
moderne, termocentralin e ri  
"Kosova C"

"Qeverisja dhe Konkurrenca  
në Arsimin e Lartë në Kosovë"

### Faqe 3

"Handicap Kosova"  
angazhohet për pjesëmarrje  
aktive të personave me aftësi  
të kufizuara në jetën  
shoqërore

Rrjeti Ballkanik për të Drejtat  
e Njeriut bën thirrje për  
shkrime hulumtuese për librin  
vjetor 2007 për të drejtat e  
njeriut

**Mundësi të reja financimi,  
lajme, aktivitete,  
trajnime, etj**

mund të lexoni në  
web faqen e ATRC-së:  
[www.advocacy-center.org](http://www.advocacy-center.org)

Rr. Agim Ramadani Nr. 15  
Kati i 2-të Prishtinë, Kosovë Te-  
lefon/Fax: +381 (0) 38 244 810

# AVOKUESI

## Reforma pensionale

### Pensionistët dhe minatorët kërkojnë miratimin e draft ligjit pensional

Pensionistë, minatorë, përfaqësues të qeverisë dhe shoqërisë civile janë takuar më 28 mars në zyrat e ATRC-së për të shqyrtuar sistemin e pensioneve në Kosovë dhe gjendjen e rëndë sociale të minatorëve, gjatë një debati publik të organizuar nga ATRC-ja dhe Shoqata e Minatorëve Pensionist Invalid të Kosovës (ShMPI).

Naser Avdiu, kryesues i ShMPI-së deklaroi se minatorët janë në gjendje të mjerueshme "pa përkujdes-

jen e qeverisë".

Aziz Abrashi, ish drejtor i kombinatit "Trepça" ua përkujtoi pjesëmarrësve kontributin e minatorëve për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ai shtoi se "minatorët ishin të parët që reagon ndaj regjimit të Millosheviçit, prandaj është e papranueshme që ky segment i shoqërisë të përfundoj me një epilog të tillë, në mungesë të ushqimit, barnave dhe veshjes". Abrashi u sugjeroi minatorëve që të organizohen dhe avokojnë

për realizimin e kërkesave të tyre sociale.

Pjesëmarrësit konkluduan që sistemi pensional urgjentisht duhet të reformohet dhe i bën thirrje qeverisë ta miratoj dhe implementoj draft ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor.

Sipas tyre, në Kosovë ka burime të mjaftueshme për të financuar pensionet.

### Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës vetëdijëson nxënësit për ndërtimet e paligjshme

Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës (IQMQP) është duke implementuar një projekt të ri me qëllim të vetëdijësimin të nxënësve për ndërtimet e paligjshme në Prishtinë. "Në kuadër të kësaj iniciative, nxënësit do të informohen për infrastrukturën urbane të qytetit të tyre", ka thënë Zijadin Gashi, kryesues i IQMQP-së duke iu referuar projektit, realizimi i të cilit përfundon në muajin qershor. IQMQP-ja është OJQ që synon ndërprerjen e ndërtimeve të paligjshme në Prishtinë.

Kjo iniciativë është përkrahur nga ATRC dhe IREX në kuadër të Programit Kosovar për Shoqërinë Civile, të financuar nga USAID.

Për informata më të hollësishme, kontaktoni: [iqmqp@yahoo.com](mailto:iqmqp@yahoo.com)



Iniciativa Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës që synon ndërprerjen e ndërtimeve të paligjshme në kryeqytetin e Kosovës

Publikimi i këtij buletini mundësohet nga përkrahja zemërgjerë e popullit amerikan nëpërmjet Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e ATRC-së dhe nuk reflekton detyrimisht qëndrimet e USAID-it ose Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

## Publikim i ri

**"Qeverisja dhe Konkurrenca në Arsimin e Lartë në Kosovë"**

Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED) ka publikuar në muajin mars një hulumtim të ri për qeverisjen dhe konkurrencën në arsimin e lartë në Kosovë.

Publikimi përfshinë informata për rëndësinë e shkollimit të lartë, papunësinë dhe demografinë e të rinjve, arsimimin para-universitar, mësimdhënien, kuptimin e reformës, standardet ndërkombëtare për arsim të lartë, politizimi, ngritja e cilësisë, arsimi i lartë i komuniteteve dhe Universiteti i Mitrovicës, politikat financiare...

"Shumica e kosovarëve mendojnë se arsimi është një ndër çështjet kryesore që e ka pllakosur shoqërinë," thuhet në publikim. "Sfida kryesore është si të transformohet universiteti nga një mjet shtet-formues në institucion meritator konkurrues".

Ky projekt është financuar nga Rockefeller Brothers Fund.

Publikimin mund ta lexoni në [www.kipred.net](http://www.kipred.net)



Shumica e kosovarëve mendojnë se arsimi është një ndër çështjet kryesore që e ka pllakosur shoqërinë, thuhet në publikim

**Mundësi financimi për OJQ-të****Swiss Contact krijon mundësi për zhvillim ekonomik**

Claudia Ulrike Gminder përfaqësuese e Swiss Contact ka informuar OJQ-të vendore për programet e kësaj organizate gjatë një takimi të organizuar nga ATRC-ja më 4 prill.

Gminder është përqendruar në projektin Gratë në Biznes, qëllimet e financimit, prioritetet dhe procedurat e aplikimit.

"Projekti i Zhvillimit të Grave në Biznes synon të kontribuoj në pjesëmarrjen e grave në ekonominë e Kosovës me fokus të veçantë në shtimin e të ardhurave të grave në sektorët me tendencë zhvillimi," ka thënë Gminder.



Swiss Contacti është OJQ e cila përkrah projektet për zhvillim ekonomik

Swiss Contact, organizatë joqeveritare dhe joprofitabile me seli në Cyrih të Zvicrës, është e pranishme në Kosovë që nga nëntori i vitit 2000. Swiss Contact përkrah projektet për zhvillim ekonomik në 28 vende të botës.

Për fondet e Swiss Contactit dhe procedurat e aplikimit mund të informoheni në [www.swisscontact-kos.org](http://www.swisscontact-kos.org)

Prezantimet e donatorëve janë pjesë e një iniciative të ATRC-së me qëllim të njoftimit të OJQ-ve për mundësitë e financimit, dhe takimit të donatorëve me OJQ që kanë interesa të ngjashme.

**Shoqëria civile e quan përrallë moderne, termocentralin e ri "Kosova C"**

"Forumi 2015" ka organizuar tryezë të rrumbullakët më 19 prill në hotelin Grand në Prishtinë të titulluar "Një përrallë moderne, Kosova C- 2100", në të cilën morën pjesë përfaqësues të institucioneve lokale, ndërkombëtare dhe shoqërisë civile.

Tryeza është fokusuar në aspektet e ndjeshme që kanë të bëjnë me zhvillimin afatgjatë të sektorit të energjisë në Kosovë.

Anëtarët e Forumit i rekomanduan Qeverisë së Kosovës shtyrjen e afatit të shpallur për ndërtimin e termocentralit të ri "Kosova C", pasi sipas tyre "për ndërtimin e një termocentrali të tillë nevojitet më shumë kohë për të studiuar më mirë efektet pozitive dhe negative të këtij projekti".

Kur qeveria ka bërë pu-

blike planet për ndërtimin e termocentralit të ri më 2006, është kritikuar ashpër, sidomos nga ambientalistët.

Luan Shllaku, kryesues i ekipit të ekspertëve i cili ka përgatitur raportin "Një përrallë moderne, termocentrali 2100 megavat", ka deklaruar se në Kosovë janë duke u bërë plane për ndërtimin e kapaciteteve të reja termoelektrike të cilat së bashku me zgjerimin e mihjeve ekzistuese të linjitet do të dëmtonin ambientin.

"Forumi 2015" është koalicioni i Fondacionit Kosovar



Ambientalistët kanë kritikuar planet e qeverisë për ndërtimin e një termocentrali të ri  
Foto: Termocentrali në Kastriot, Kosovë

për Shoqëri të Hapur - Soros dhe Riinvestit që synon bashkërendimin e aktiviteteve të shoqërisë civile në Kosovë drejt integritimit Euro-Atlantik.

Për më shumë informata, vizitoni [www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

**atrc****Executive Director**  
RREZE DULI  
rreze@advocacy-center.org**Financial & Administration  
Manager**  
GANI ASLLANI  
gani@advocacy-center.org**Grant Manager**  
TEUTA LUZHA  
teuta@advocacy-center.org**Grant Officer**  
KUSHTRIM KALOSHI  
kushtrimk@advocacy-center.org**Grant Officer**  
XHAFER AHMETI  
xhafer@advocacy-center.org**Grant Finance Manager**  
SAFETA XHEKOVIQ  
safeta@advocacy-center.org**Training & Consultancy  
Services Manager**  
DONIKA SALIHU  
donika@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
AFERDITA SURROI  
aferdita@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
KUSHTRIM ISLAMI  
kushtrim@advocacy-center.org**Trainer & Consultant**  
NORA SUSURI  
nora@advocacy-center.org**Communication & Outreach  
Manager**  
ARJETA DOROCI  
arjeta@advocacy-center.org**Program Officer**  
NATYRA ZHJEQI  
natyra@advocacy-center.org**IT and Database Manager**  
ARSIM KOSUMI  
arsim@advocacy-center.org**Prezantim i një OJQ-je lokale****"Handicap Kosova" angazhohet për pjesëmarrje aktive të personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore**

Shoqata e personave me paralizë të fëmijëve "Handicap Kosova" është organizatë joqeveritare humanitare e themeluar në vitin 2001, e cila ka për qëllim ngritjen e vetëdijes publike për personat me aftësi të kufizuara në Kosovë; integrimin e këtij grupi në shoqëri; vlerësimin e gjendjes së tyre shëndetësore, sociale dhe materiale; motivimin e një pjesëmarrjeje më aktive në jetën shoqërore; dhe ndërtimin e kapaciteteve të OJQ-ve që merren me këtë fushë.

"Handicap Kosova" konsideron se "personat me aftësi të kufizuara janë të diskriminuar si rezultat i mos mbrojtjes ligjore dhe mos pranimit të këtij grupi në shoqëri".

Për këtë shkak, "Handicap Kosova" punon për përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri me të drejta të barabarta me të gjithë qytetarët e Kosovës. Kjo OJQ tenton t'i organizoj personat me aftësi të kufizuara duke i informuar ata për mundësitë përmes së cilave mund të avokojnë për jetë më të mirë.

"Handicap Kosova" realizon qëllimet e veta përmes implementimit të projekteve, partneritetit me të tjerët dhe avokimit. Projektet e saj përfshijnë hulumtim për polio-mielitin në Kosovë, festivalin për ditën ndërkombëtare të fëmijëve, radio dhe TV programe për personat me aftësi të kufizuara, ngritje të kapaciteteve të shoqatave të personave me aftësi të kufizuara, etj.

*Për më shumë informata, kontaktoni: zarsye@yahoo.com*

**Të drejtat e njeriut****Rrjeti Ballkanik për të Drejtat e Njeriut bën thirrje për shkrime hulumtuese për librin vjetor 2007 për të drejtat e njeriut**

Rrjeti Ballkanik për të Drejtat e Njeriut (BHRN) është i interesuar për shkrime dhe recension librash për edicionin e shtatë të Librit për të Drejtat e Njeriut. Ky publikim vjetor promovon dhe hulumton të arriturat dhe përvojat e vendeve ballkanike në zbatimin e të drejtave të njeriut. Çdo vit BHRN zgjedh një temë të rëndësishme për rajonin e Ballkanit. Tema e këtij është "Synimet e Mileniumit për Zhvillim - sfidë për OJQ-të për të drejtat e njeriut në Ballkan: Punësimi i të Rinjve".

Artikuj hulumtues nga perspektiva, teori, qasje ose metodologji të



ndryshme janë të mirëseardhura.

Shkrimet rekomandohet të jenë nga komuniteti i rajonit

për të drejtat e njeriut, me interes të veçantë ndaj zërave ose perspektivave të praktikantëve dhe studiuesve të rinj. Shkrimet hulumtuese duhet të paraqesin vendin në lidhje me temën e caktuar.

Për informata më të hollësishme, kontaktoni sekretariat@balkan-rights.net ose vizitoni [www.balkan-rights.net](http://www.balkan-rights.net).

Për më shumë informata për Synimet e Mileniumit për Zhvillim vizitoni: <http://www.un.org/millenniumgoals/>

*Burimi: Balkan Academic News*